

**UNITED  
NATIONS**

United Nations  
Interim  
Administration  
Mission  
in Kosovo



**UNMIK**

**NATIONS UNIES**

Mission  
d'Administration  
Intérimaire des  
Nations Unies au  
Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Ligjislatura e dytë**

*Komisioni për Shëndetësi ,Punë  
dhe Mirëqenie Sociale  
Nr. 23/2007*

**PROCESVERBAL**

*i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të mbajtur më  
4. 9. 2007, në sallën N-225, në orën 13.00*

**Të pranishëm:** Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, kryetare : Naim Jerliu, Shpresa Murati,  
Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Zylfije Hundozi, Rudina, Flora Brovina, Fehmi Vula dhe  
Ferid Agani , anëtarë.

**Munguan :** Zllatica Kujunxhiq, Rudina Bukoshi, Nurishahe Hulaj dhe Zahrije Jusufi .

Mbledhjen e drejtoi **Fatmire Mulhaxha – Kollçaku** dhe propozoi këtë:

**REND DITE**

- 1. Takim me ministrin e Shëndetësisë z. Sadik Idriz lidhur me formimin e Këshillit të Përgjithshëm Profesional;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e punës;**
- 3. Miratimi i procesverbaleve të dates 29 dhe 30.8.2007**

**Rendi i ditës u miratua .**

**U hap shqyrtimi për pikën e parë.**

- 1 Takim me ministrin e Shëndetësisë z. Sadik Idriz lidhur me formimin e Këshillit të Përgjithshëm Profesional**

**Fatmire Mulhaxha –Kollçaku** pasi e përshëndeti ministrin dhe të pranishmit tha : Qëllimi i takimit është që Komisioni të njoftohet se deri ku ka arritur lidhur me formimin e Këshillit të Përgjithshëm Profesional. Ministria e Shëndetësisë

**Ministri Sadik Idriz** vuri në pah : Ministria e Shëndetësisë ka arritur rezultate pozitive, në krahasim me periudhën e vitit të kaluar në të gjitha fushat. Ai tha se tani para Ministrisë gjendet projekti- propozimi për themelimin, përbërjen dhe funksionimin e Këshillit të Përgjithshëm Profesional .Me këtë udhëzim administrativ rregullohet themelimi, përbërja, organizimi dhe detyrat e tij. Këshilli mbron dhe përfaqëson interesat e profesionisteve mjekësorë përmes bordeve. Ai pastaj, në vijë të trasha i njoftoi anëtarët e Komisionit me funksionet dhe përgjegjësitë e Këshillit të Përgjithshëm Profesional dhe strukturën e tij.

**Fatmire Mulhaxha** shtroi çështjen e kontratave të punës dhe apeloj që të veprohet për të gjithë njësoi me rastin e vazhdimit të tyre

**Teuta Hadri** , duke u ndërlidhur me diskutimin e ministrit Sadik Idriz kërkoi sqarim rreth mbajtjes së testeve dhe a kompensohet puna . Ajo nënvizoi se gjatë studimeve në fakultete kuadrat kanë arritur njohurit e mjaftueshme ,prandaj rivlerësimi i serishëm do të ishte i tepërt.

Deputetët : Naim Jerliu,Flora Brovina, Zylfije Hundozi, Ilaz Pireva, Fehmi Vula,Ferid Agani dhe Teuta Hadri shtruan pyetje të cilave ministri iu përgjigj.

**Naim Jerliu** i propozoi Komisionit nxjerrjen e një përfundimi lidhur me këtë pikë që u mbështet nga të pranishmit.

## **P e r f u n d i m**

**Komisioni kërkon nga Ministria e Shëndetësisë që të mos procedojë me emërimin e anëtarëve të Bordit Etik Profesional deri në nënshkrimin e Udhëzimit Administrativ për themelimin, përbërjen dhe funksionimin e Këshillit të Përgjithshëm Profesional.**

U hap shqyrtimi për pikën e dytë.

## **2 Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e punës**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës Komisioni vendosi të mos procedohet më tutje nga se paraprakisht duhet të konsultohet ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale . Komisioni vendosi që në mbledhjen ardhshme të debatohet lidhur me këtë Projektligj, në praninë e ministrit z. Ibrahim Selmanaj.

U hap shqyrtimi për pikën e tretë.

## **3 Miratimi i procesverbaleve të dates 29 dhe 30.8.2007**

Pasi nuk pati vërejtje, u miratuan .

Procesmbajtës,  
Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor

**Kryetarja e Komisionit  
Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**